

VENDIM
Nr.160, datë 21.3.2006

**PËR RRYTJEN E SHITESËS MBI PENSION PËR INVALIDËT E LUFTËS KUNDËR
PUSHTUESVE NAZIFASHISTË TË POPULLIT SHQIPTAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 3 të ligjit nr.7663, datë 20.1.1993 “Për statusin e invalidit të luftës kundër pushtuesve nazifashistë të popullit shqiptar” dhe të nenit 3 të ligjit nr.9464, datë 28.12.2005 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2006”, me propozimin e Ministrit të Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shtesa mujore, e përfituar sipas ligjit nr.7663, datë 20.1.1993 “Për statusin e invalidit të luftës kundër pushtuesve nazifashistë të popullit shqiptar”, të rritet në masën 20 për qind.
 2. Efektet financiare, në shumën 12 300 000 (dymbëdhjetë milionë e treqind mijë) lekë, për zbatimin e këtij vendimi, për vitin 2006, të përballohen nga fondet e parashikuara në buxhetin e po këtij viti, miratuar për Institutin e Sigurimeve Shoqërore.
 3. Ngarkohet Instituti i Sigurimeve Shoqërore për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1.3.2006.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha